



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 61, datë 4.11.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE KUR ZBATOHEN
MASAT E NDËRHYRJES SË HERSHME DHE PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E KRYERJES
SË ADMINISTRIMIT TË PËRKOHSHËM”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 17, pika 3, dhe nenit 19, pika 13, të ligjit nr.133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për përcaktimin e kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe të kushteve dhe mënyrës së kryerjes së administrimit të përkohshëm”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 30 qershor 2021.

SEKRETARI

ZËVENDËSKRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Luljeta MINXHOZI

RREGULLORE

“PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE KUR ZBATOHEN MASAT E NDËRHJRJES SË HERSHME DHE PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E KRYERJES SË ADMINISTRIMIT TË PËRKOHSHËM”

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe i kushteve dhe mënyrës së administrimit të përkohshëm.

Neni 2 Baza juridike

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja ”c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) nenit 17, pika 3, dhe nenit 19, pika 13, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme”).

Neni 3 Përkufizime

- 1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 4 dhe Kreun IV të ligjit “Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.
- 2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) “Masa të ndërhyrjes së hershme” – janë masat e ndërhyrjes së hershme të përcaktuara in nenin 17 të ligjit “Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme”;
 - b) “Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës” (PRVM) – është pjesë integrale e procesit mbikëqyrës që ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, siç përcaktohet në kërkesat e udhëzuesit nr. 26, datë 3.5.2017, “Mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit”;
 - c) “Vlerësimi i përgjithshëm i bankës” - është vlerësimi, i bazuar mbi pikët e caktuara për secilin nga elementet e PRVM-së, dhe merr në konsideratë të gjithë informacionin në dispozicion për bankën;

- d) "Vlerësimi i elementeve të rrezikut" – është vlerësimi, i cili merr në konsideratë vlerësimin e elementeve sasiore dhe atyre cilësore të rrezikut;
 - e) "Pikëzimi i përgjithshëm i PRVM-së" - është treguesi numerik i rrezikut të përgjithshëm ndaj qëndrueshmërisë së bankës, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të saj (bankës).
3. Në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës, sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 6, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

KREU II

PËRCAKTIMI I KUSHTEVE PËR MASAT E NDËRHJRJES SË HERSHME

Neni 4

Kushtet për zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme

1. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse do zbatojë masat e ndërhyrjes së hershme, kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:
 - a) pikëzimi i përgjithshëm i gjendjes së bankës, bazuar në PRVM, është në nivelin 6; ose
 - b) pikëzimi i përgjithshëm i gjendjes së bankës, bazuar në PRVM, është në nivelin 5 dhe pikëzimi i të paktën njërit prej elementeve të mëposhtme të PRVM-së është i vlerësuar në nivelin 6:
 - i. drejtimi i brendshëm dhe sistemet e kontrollit,
 - ii. rreziku i kredisë,
 - iii. rreziku i likuiditetit,
 - iv. rreziku strategjik dhe modeli i biznesit,
 - v. vlerësimi i kapitalit bazuar në PRVM,
 - vi. vlerësimi i likuiditetit bazuar në PRVM;
 - c) kur evidentohen ndryshime materiale ose anomali në treguesit e PRVM-së, sipas përcaktimit në nenin 5 të kësaj rregulloreje; ose
 - d) kur ndodhin ngjarje të rëndësishme, sipas përcaktimit në nenin 6 të kësaj rregulloreje.
2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni:
 - a) kryen analizën e nevojshme dhe dokumenton shkaqet që mund të çojnë në marrjen e masave për ndërhyrje të hershme; dhe
 - b) vlerëson urgjencën e situatës dhe rëndësinë e problematikës në situatën e përgjithshme të bankës, me qëllim që të vendosë për llojin e masave për ndërhyrje të hershme që duhet të ndërmarret.
3. Banka e Shqipërisë dokumenton të gjithë informacionin që lidhet me evidentimin e kushteve/situatave të ngjashme, të rezultateve të analizave të mëtijshme dhe të vendimmarrjes për zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme, si dhe arsyet përkatëse në rastin e mosmarrjes së masave të ndërhyrjes së hershme.

4. Banka e Shqipërisë, në rastet kur vendos të zbatojë një masë të ndërhyrjes së hershme, merr parasysh masat e përcaktuara në planin e rimëkëmbjes që banka ka marrë ose ka vendosur të marrë në të ardhmen e afërt.
5. Banka e Shqipërisë, në rastet kur e vlerëson bankën me një rezultat të përgjithshëm të PRVM-së '6', merr parasysh sigurimin e të gjithë informacionit të nevojshëm për vlerësimin e aktiveve dhe të detyrimeve të bankës, edhe në funksion të zbatimit të shkronjës "dh", pika 1, të nenit 17, të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme".
6. Banka e Shqipërisë, në rastet kur vendos zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme bazuar në rezultatet (pikët) e mësipërme të PRVM-së dhe për zgjedhjen e masës më të përshtatshme, trajton dobësitë e veçanta të identifikuar dhe të theksuara në përshkrimin e vlerësimit të përgjithshëm të PRVM-së ose të vlerësimit të një elementi të veçantë të tij.
7. Banka e Shqipërisë, nëse banka plotëson kushtet për ndërhyrje të hershme, vendos të zbatojë masat e ndërhyrjes së hershme, menjëherë pas përcaktimit të shkaktit dhe ndikimit të përgjithshëm, pa përditësuar vlerësimin e elementit përkatës të PRVM-së. Vlerësimi i elementit përkatës të PRVM-së dhe vlerësimi i përgjithshëm i PRVM-së duhet të përditësohet më pas pa vonesa të panevojshme.

Neni 5

Monitorimi i treguesve nën PRVM

1. Procesi i vlerësimit të rreziqeve kërkon që Banka e Shqipërisë të kryejë monitorim të rregullt të treguesve të PRVM-së për të gjitha bankat.
2. Banka e Shqipërisë e konsideron evidentimin e ndryshimeve materiale dhe anomalive në tregues, përfshirë shkeljet e kufijve, si shtysë për një analizë të mëtejshme, dhe, aty ku është e mundur, rishikon vlerësimin lidhur me elementet e PRVM-së, në bazë të të dhënave të reja. Banka e Shqipërisë, në veçanti:
 - a) përcakton shkaktin dhe kryen vlerësimin e materialitetit të ndikimit të mundshëm (potencial) në një bankë dhe, ku është me rëndësi, angazhohet në një dialog efektiv me bankën;
 - b) dokumenton shkaktin/qet dhe rezultatet e vlerësimit; dhe
 - c) aty ku është me rëndësi, rishikon vlerësimin e rrezikut dhe pikëzimin e PRVM-së, në sajë të çdo gjetjeje materiale të re.
3. Banka e Shqipërisë, në rastet kur gjendja financiare e bankës dhe perspektiva e rrezikut për elemente të caktuara të PRVM-së përkeqësohen ndjeshëm dhe ndikojnë në një nga kushtet e bazuara në kombinimin e pikëzimit të përgjithshëm të PRVM-së dhe pikët për elementet individuale të PRVM-së, merr vendimin nëse duhet të zbatojë masat e ndërhyrjes së hershme.
4. Banka e Shqipërisë, pa rënë në kundërshtim me pikën 3 të këtij neni, mund të përdorë drejtpërsëdrejti, në rrethana të caktuara, ndryshimet materiale ose anomalitë në tregues, për të vendosur zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme.

Neni 6

Ngjarje të rëndësishme

1. Ngjarje të caktuara mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në gjendjen financiare të bankës, duke e vendosur atë në një situatë ku kushtet për ndërhyrjen e hershme janë përmbushur relativisht shpejt, duke ndryshuar ose duke mos ndryshuar pikëzimi i përgjithshëm i gjendjes së bankës bazuar në PRVM, sipas përcaktimeve të nenit 4 të kësaj rregulloreje.
2. Shembuj të ngjarjeve të rëndësishme, por jo vetëm, që mund ta vënë bankën përpara një situatë ku janë përmbushur kushtet për ndërhyrjen e hershme, mund të përfshijnë:
 - a) ngjarje madhore të rrezikut operacional (për shembull mashtrim, fatkeqësi natyrore, probleme të teknologjisë së informacionit, gjopa të konsiderueshme nga autoritetet publike);
 - b) rënie e qenësishme e vlerës së detyrimeve të pranuara dhe e kapitalit rregullator të mbajtur nga banka, për përmbushjen e kërkesave minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara;
 - c) sinjalizime për nevojën e rishikimit të cilësisë së aktiveve dhe/ose kryerjen në mënyrë të pavarur të vlerësimit të portofoleve/aktiveve specifike, si për shembull:
 - i. rezultatet e ekzaminimit në vend, të raporteve të kredimarrësve nga regjistri i kredisë, raportimet periodike etj.,
 - ii. opinionin e audituesit të jashtëm mbi pasqyrat financiare të bankës evidenton/thekson pasiguri materiale,
 - iii. ngjarje me efekte të mundshme financiare ose mbi treguesit e tjerë të bankës, të cilat nuk janë pasqyruar ende në pasqyrat financiare të bankës,
 - iv. rregullime të vazhdueshme dhe materiale të pasqyrave financiare të bankës, për shkak të gabimeve në vlerësimin e aktiveve/detyrimeve dhe ndryshimeve të shpeshta në trajtimet/supozimet kontabël;
 - d) flukse dalëse të konsiderueshme të fondeve, duke përfshirë depozitat me pakicë të konsumatorëve, të shkaktuara, për shembull, nga rënia e reputacionit të bankës;
 - e) largimet e paparashikuara në përbërjen e këshillit drejtues ose stafit drejtues kryesor, të cilët nuk janë zëvendësuar;
 - f) një ose më shumë anëtarë të këshillit drejtues shkelin kërkesat ligjore dhe rregullative për administratorët e bankave, për t'u emëruar anëtarë apo për të mbetur anëtarë të këshillit drejtues;
 - g) rënie të rëndësishme të vlerësimit të bankës nga një ose më shumë agjenci të vlerësimit të jashtëm, të cilat mund të çojnë në tërheqje të konsiderueshme të fondeve, paaftësi për të rinovuar kontratat e financimit ose aktivizim të kushteve të caktuara kontraktuale që lidhen me vlerësimin e bankës nga këto agjenci.

3. Banka e Shqipërisë, pasi vihet në dijeni për një ngjarje të rëndësishme, identifikon shkakun e saj, vlerëson ndikimin e saj të mundshëm (potencial) mbi bankën dhe, ku është e mundur, angazhohet në një dialog efektiv me bankën, si dhe dokumenton vlerësimin e saj.
4. Në rrethana të veçanta, ngjarjet e rëndësishme mund të përdoren si kusht për marrjen e vendimit mbi zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme. Banka e Shqipërisë, në veçanti, në varësi të madhësisë së ngjarjes së rëndësishme dhe të materialitetit të ndikimit prudencial të mundshëm mbi bankën dhe nëse banka i plotëson kushtet për ndërhyrjen e hershme, mund të vendosë të zbatojë masat për ndërhyrjen e hershme, menjëherë pas përcaktimit të shkakut dhe ndikimit të përgjithshëm, pa përditësuar vlerësimin e elementit përkatës të PRVM-së. Vlerësimi i elementit përkatës të PRVM-së dhe vlerësimi i përgjithshëm i PRVM-së duhet të përditësohet më pas pa vonesa të panevojshme.
5. Në rast se Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme fillon procesin e konsultimit me Departamentin e Mbikëqyrjes për të përcaktuar nëse një bankë është në kushtet e paaftësisë paguese, Departamenti i Mbikëqyrjes e konsideron këtë si ngjarje të rëndësishme për të vlerësuar zbatimin e masave të ndërhyrjes së hershme, për të ruajtur ose rivendosur rentabilitetin dhe për të parandaluar paaftësinë paguese të bankës.

KREU III ADMINISTRIMI I PËRKOHSHËM

Neni 7

Kushtet për zbatimin e administrimit të përkohshëm

1. Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka nuk zbaton masat e ndërhyrjes së hershme të kërkuara prej saj (Bankës së Shqipërisë) për përkeqësim të konsiderueshëm të gjendjes financiare të bankës ose për shkelje me pasoja të rënda të legjislacionit në fuqi për bankat dhe të rregullave të tjera apo statutit të bankës dhe në rast se këto masa nuk janë të mjaftueshme për të korrigjuar gjendjen financiare të saj (bankës), mund të urdhërojë bankën të shkarkojë nga detyra një ose disa prej administratorëve të bankës, anëtarë të këshillit drejtues dhe/ose të drejtorisë, dhe të emërojë administratorë të rinj.
2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka nuk zbaton urdhrin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ose kur konsideron se zëvendësimi i administratorëve nga banka është i pamjaftueshëm në funksion të përmirësimit të situatës financiare të bankës, ka të drejtë të emërojë një ose më shumë administratorë të përkohshëm për bankën.
3. Administratori i përkohshëm, i emëruar sipas këtij neni, duhet të plotësojë të gjitha kushtet kualifikuese dhe skualifikuese për administratorët e bankës, të përcaktuara në ligjin “Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme”, ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 8

Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm

1. Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm dhe për detyrat që do t'i ngarkohen merret nga organi i bankës së Shqipërisë, i parashikuar në rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.
2. Vendimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë minimalisht:
 - a) emërimin e administratorit të përkohshëm;
 - b) objektivat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm;
 - c) nëse administratori i përkohshëm do të zëvendësojë këshillin drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutivë të bankës, apo do të administrojë bankën së bashku me këto organe, si dhe detyrat dhe kompetencat e tij;
 - d) ndarjen e kompetencave mes administratorit të përkohshëm dhe këshillit drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutiv të bankës, dhe akteve ligjore në lidhje me të cilat këto organe duhet të marrin mendimin dhe/ose pëlqimin (miratimin) e administratorit të përkohshëm – nëse banka administrohet bashkërisht nga administratori i përkohshëm dhe këto organe;
 - e) afatet dhe mënyrën e raportimit në Bankën e Shqipërisë;
 - f) shpërblimin e administratorit të përkohshëm;
 - g) mandatin e administratorit të përkohshëm.
3. Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm në një bankë ose shkarkimi apo zëvendësimi i tij, në rastet kur autorizohet të përfaqësojë bankën me palët e treta, regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) brenda 5 (pesë) ditësh nga data e marrjes së vendimit. Vendimi publikohet gjithashtu në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 9

Kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm

1. Administratori i përkohshëm ushtron kompetencat dhe përmbush detyrat e përcaktuara në ligjin “Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme” dhe në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm dhe është përgjegjës për moszbatimin e detyrave të tij në Bankën e Shqipërisë.
2. Banka e Shqipërisë përcakton kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, në përputhje me kompetencat e këshillit drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutiv, si dhe me të drejtat, detyrat dhe kompetencat e anëtarëve të këtyre organeve të përcaktuara me ligj, statutet e bankës dhe ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
3. Kompetencat e administratorit të përkohshëm përcaktohen në mënyrë të tillë që të ndahen qartë përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e tij me organet e tjera të bankës, të cilat mund të përfshijnë pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit drejtues dhe drejtuesve të bankës, thirrjen e mbledhjeve të këtyre organeve dhe të komiteteve të tjera të bankës, duke propozuar axhendën e takimeve të tilla, duke propozuar miratimin e vendimeve të duhura, duke kërkuar raporte të përshtatshme nga këshilli drejtues, si dhe nga komitete të tjera dhe njësitë përkatëse të bankës etj.

4. Objektivat dhe detyrat e administrimit të përkohshëm mund të lidhen me përcaktimin e gjendjes financiare të vërtetë të bankës, të administrimit të të gjithë ose të një pjese të veprimtarisë së bankës, me qëllim ruajtjen ose rivendosjen e pozicionit të duhur financiar të bankës dhe/ose aktivitetin e saj të sigurt dhe të shëndoshë, mbikëqyrjen mbi veprimtaritë e përcaktuara me vendim të Bankës së Shqipërisë, mbikëqyrjen mbi kryerjen e aktiviteteve të këshillit drejtues ose të drejtuesve ekzekutivë dhe të komiteteve të tjera të bankës.
5. Në rastet kur vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm përcakton se administratori duhet të zëvendësojë këshillin drejtues dhe/ose drejtuesit ekzekutivë të bankës, funksionet e anëtarëve të këtyre organeve do të përfundojnë që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për zbatimin e administrimit të përkohshëm dhe funksionet e tyre do të transferohen tek administratori i përkohshëm.
6. Banka i jep administratorit të përkohshëm akses në të gjitha njësitë organizative dhe godinat e bankës, mundëson komunikimin e tij me menaxherët/administratorët dhe punonjësit e bankës dhe i vë në dispozicion të dhënat mbi veprimtarinë e bankës dhe dokumente të tjera të nevojshme për të përmbushur objektivat dhe detyrat e përmendura më lart.
7. Nëse Autoriteti Mbikëqyrës e emëron administratorin e përkohshëm për të bashkëpunuar me këshillin drejtues të bankës, atëherë këshilli drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë të bankës marrin nga administratori i përkohshëm pëlqimin paraprak dhe/ose një opinion mbi akte të caktuara dhe veprime ligjore të ndërmarra nga këto organe, të cilat përcaktohen në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm. Aktet apo veprimet ligjore mund të jenë, por pa u kufizuar, për miratimin e kredisë dhe dhënien e shërbimeve të tjera financiare ndaj personave që lidhen me bankën, huamarrjen e bankës, investimin e bankës në aktive ose subjekte të tjera ligjore, shitjen e aktiveve të bankës, futjen e produkteve të reja, përcaktimin e shpërblimit të anëtarëve të organeve drejtuese të bankës dhe administrimit, duke përfshirë bonuset dhe shpërblimet që u paguhen këtyre personave ose punonjësve të tjerë të bankës.
8. Administratori i përkohshëm, në çdo rast para mbledhjes së asamblesë së bankës dhe caktimit të axhendës së mbledhjes së asamblesë, merr pëlqimin paraprak nga Banka e Shqipërisë, e cila në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm mund të përcaktojë që një pëlqim i tillë duhet të merret gjithashtu përpara ndërmarrjes së veprimeve të caktuara juridike.

Neni 10

Raportimi i administratorit të përkohshëm

1. Në rast se nuk përcaktohet ndryshe në vendimin e emërimit të administratorit të përkohshëm, ky i fundit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit, paraqet në Bankën e Shqipërisë një raport mbi veprimtarinë dhe gjendjen financiare të bankës, që përmban një vlerësim të gjendjes financiare dhe perspektivave të bankës për përmirësimin e veprimtarive të saj.

2. Nëse në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm përcaktohet se administratori i përkohshëm do të menaxhojë/administrojë bankën së bashku me këshillin drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë të bankës, raporti do t'u dorëzohet gjithashtu këtyre organeve që mund të paraqesin kundërshtime ndaj raportit dhe t'ia paraqesin ato administratorit të përkohshëm dhe Bankës së Shqipërisë, brenda pesë ditëve nga data e pranimit të raportit.
3. Administratori i përkohshëm i paraqet Bankës së Shqipërisë mendimin e tij për kundërshtimet e përmendura më sipër, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së tyre.
4. Administratori i përkohshëm, së bashku me raportin, paraqet në Bankën e Shqipërisë një plan veprimi për përmbushjen e objektivave dhe detyrave përgjatë gjithë periudhës së mandatit të tij.
5. Administratori i përkohshëm i paraqet Bankës së Shqipërisë, minimalisht mbi baza tremujore edhe në çdo rast që kërkohet nga Banka e Shqipërisë, një raport mbi veprimet e ndërmarra për të përmbushur objektivat dhe detyrat, shkallën në të cilën janë përmbushur këto objektiva dhe detyra, si dhe aktivitetet dhe afatet e planifikuara për zbatimin e tyre në periudhën në vazhdim.
6. Administratori i përkohshëm njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo rrethanë që mund të çojë në paaftësinë e bankës për të zbatuar masat e vëna dhe përkeqësimin e gjendjes financiare të saj, si dhe për shpërndarjen e planifikuar të fitimit të bankës ndaj aksionerëve, anëtarëve të organeve drejtuese dhe punonjësve, nëse vlerëson se një shpërndarja e tillë mund të çojë në shkelje të kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi.
7. Banka e Shqipërisë, bazuar në raportet dhe informacionet e përcaktuara më sipër dhe në të dhënat e tjera në dispozicion të saj, mund të vendosë ndonjë nga masat mbikëqyrëse të përcaktuara në ligj "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe/ose të vendosë bankën në administrimin e posaçëm, nëse vlerëson se mund të kontribuojë në arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 11

Shpërblimi i administratorit të përkohshëm

1. Banka e Shqipërisë përcakton shpërblimin e administratorit të përkohshëm, duke pasur parasysh në veçanti:
 - a) fushën e zbatimit të detyrave, kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, të përcaktuar në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm;
 - b) pagën mesatare mujore të anëtarëve të këshillit drejtues dhe drejtuesve ekzekutivë për tre muajt para miratimit të vendimit për zbatimin e administrimit të përkohshëm;
 - c) shumën e aktiveve të parashikuara që do të administrojë gjatë mandatit të tij administratori i përkohshëm;
 - d) gjendjen financiare të bankës; dhe
 - e) të dhëna të tjera të rëndësishme për përcaktimin e këtij shpërblimi.

2. Shpërblimi për administratorin e përkohshëm paguhet nga banka, e cila është vendosur në administrim të përkohshëm.

Neni 12

Mandati i administratorit të përkohshëm

1. Administratori i përkohshëm emërohet për një mandat jo më shumë se një vit, i cili mund të zgjatet vetëm me vendimin e Bankës së Shqipërisë dhe nëse vazhdojnë të plotësohen kushtet për administrimin e përkohshëm.
2. Administratori i përkohshëm, në rast shtyrjeje të mandatit, duhet të informojë aksionerët e bankës për arsyet e kësaj shtyrjeje.
3. Banka e Shqipërisë, gjatë mandatit të administratorit të përkohshëm, mund të nxjerrë në çdo kohë një vendim për ta shkarkuar atë dhe mund të ndryshojë gjithashtu kompetencat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, të përcaktuar në vendimin për zbatimin e administrimit të përkohshëm.
4. Banka e Shqipërisë, kur vlerëson se administratori i përkohshëm nuk respekton afatet e raportimit dhe nuk përmbush detyrat dhe objektivat e vendosura nga Banka e Shqipërisë në vendimin e emërimit, vendos ndërprerjen e parakohshme të mandatit të administratorit të përkohshëm.

Neni 13

Përfundimi i administrimit të përkohshëm

1. Banka e Shqipërisë përfundon administrimin e përkohshëm:
 - a) me përfundimin e afatit të përcaktuar në vendimin për emërimin e administratorit të përkohshëm dhe/ose vendimin për zgjatjen e mandatit të administratorit të përkohshëm;
 - b) para përfundimit të afatit të përcaktuar, nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se janë përmbushur objektivat dhe detyrat, ose gjendja financiare e bankës është përmirësuar aq sa administrimi i përkohshëm nuk është më i nevojshëm;
 - c) me zbatimin e administrimit të posaçëm;
 - d) me vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme; dhe
 - e) me kalimin në likuidim.
2. Banka e Shqipërisë, në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nxjerr një vendim për përfundimin e administrimit të përkohshëm, të cilin ia paraqet QKB-së, me qëllim që të regjistrojë përfundimin e administrimit të përkohshëm.

ZËVENDESKRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Luljeta MINXHOZI

